

POSTA AJRORE

Nëntor 2020

Rihapet gara për Aeroportin e Vlorës Ministria Balluku zbulon detajet e garës

Tiranë, më 23 nëntor 2020

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku, njofton rihapjen e garës për ndërtimin dhe operimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës.



Afati për dorëzimin e ofertave nga ana e kompanive është deri në datën 23 dhjetor 2020, ndërsa më pas do të bëhet vlerësimi i ofertave të paraqitura. Sipas ministres Balluku shpallja e kompanisë fituese do të bëhet në mes të muajit janar, të vitit 2021, pas vlerësimeve nga ana e ekspertëve dhe konsulentëve të cilët janë pjesë e këtij procesi.

Deklarata e plotë e Ministres Belinda Balluku:


Në 19 dhjetor të 2019-ës hapëm garën ndërkombëtare për ndërtimin dhe operimin e aeroportit ndërkombëtar

të Vlorës. Më pas ngjarjes rrodhën ashtu siç ne nuk do deshëm, pandemia, mbyllja jo vetëm e Shqipërisë, por e të gjithë botës dhe për më tepër aviacioni civil, fusha më e goditur nga kjo pandemi, na bën që të merrnim një vendim në ato momente të duhurin, bllokuam këtë proces, e ngrimë, për ta rihapur në një moment të dytë atëherë kur investitorët ndërkombëtar do të kishin interes për t'u futur në garë. Ndoshta, për një moment të dytë, kur edhe institucionet financiare do kishin mundësi që të mbështesnin këtë projekt kaq të rëndësishëm dhe ambicioz, jo vetëm për Shqipërinë, padyshim, por për të gjithë rajonin, një shkallë më lartë në aviacionin civil.

Tashmë ka ardhur koha që të rihapet kjo garë. Pas kërkesave të shumta që kemi pasur nga investitorët kemi vendosur që duke filluar nga 23 nëntori të hapim garën ndërkombëtare për ndërtimin dhe operim e aeroportit ndërkombëtar të Vlorës, e cila do të qëndrojë hapur edhe për 30 ditë, deri në 23 dhjetor të këtij viti. Më pas, ne do të marrim kohën e duhur, atë të vendosur në ligj prej 2 javësh, për të vlerësuar ofertat që do të kenë arritur deri në datën 23 dhjetor.


Në mes të muajit Janar 2021, ne stafet tona dhe ekspertët, sigurisht dhe konsulentët që na kanë mbështetur në të gjithë këtë proces, do kenë mundësi që të nxjerrin një fitues. Shpresojmë një konsorsum ndërkombëtar i cili të jetë i denjë për ndërtimin e aeroportit të shqiptarëve. Unë shpresoj që ky lajm të jetë i mirë jo vetëm për qytetarët e Vlorës. Ky lajm është i mirë dhe i rëndësishëm për qytetarët e të gjithë Shqipërisë dhe për shqiptarët kudo që ndodhen në botë.

Znj. Kraja takim virtual me Drejtorin e Përgjithshëm të Eurocontrol



Në një takim 1-2-1 me Drejtorin e Përgjithshëm të Eurocontrol z.Eamonn Brennan për t'u prezantuar me zhvillimet më të fundit të kësaj organizate dhe për të diskutuar mbi çështje me interes për aviacionin civil shqiptar.

Në 4 nëntor 2020, Eurocontrol publikoi parashikimin mbi zhvillimet e mundshme të trafikut ajror për 5 vitet e ardhshme, bazuar në 3 skenare potenciale të zhvillimit të ngjarjeve, ku faktor kyç mbetet koha e realizimit të një vaksine efektive.



Scenario COVID-19 recovery

Optimistic and pessimistic scenarios were explored



Scenario 1

Vaccine Summer 2021
Vaccine widely made available for travellers (or end of pandemic) by Summer 2021

Recovery to 2019 level in 2024

- From mid-2021:**
- Enough testing facilities for passengers. Relatively good passenger confidence. Some travelers still reluctant to fly (elderly, leisure, business class travelers).
 - Airlines, especially LCCs, reasonably well able to invest and re-hire once demand returns.
 - Some long-haul flows restarting quicker than others (eg. North-Atlantic first).

Scenario 2

Vaccine Summer 2022
Vaccine widely made available for travellers (or end of pandemic) by Summer 2022

Recovery to 2019 level in 2026?

- From mid-2022:**
- Enough testing facilities for passengers. Relatively good passenger confidence. Some travelers still reluctant to fly (elderly, leisure, business class travelers).
 - Airlines, especially LCCs, reasonably well able to invest and re-hire once demand returns.
 - Some long-haul flows restarting quicker than others (eg. North-Atlantic first).

Scenario 3

Vaccine not effective
Lingering infection and low passenger confidence

Recovery to 2019 level in 2029?

- From mid-2022:**
- Vaccine widely made available for travellers by Summer 2022, but uptake is patchy.
 - Difficult for airlines to operate as pre-COVID-19: some airlines are experiencing renewed outbreak phases, not at the same time, not with the same severity.
 - Demand is bouncing back for 60%-70% of travellers but reluctance to fly for red (fear and/or alternatives); permanent drop in propensity to fly.

Shumë i vlefshëm suporti i Eurocontrol me anë të këtij studimi, si një burim mbi të cilin do të projektohen veprimet e të ardhmes, në përgjigje të sfidave të kohës.

Shumë i nevojshëm suporti i vazhdueshëm i Eurocontrol me anë të mekanizmave facilitues, për të bërë të mundur vijimësinë e ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror në një kohë të vështirë për aviacionin civil në mbarë globin.

KONKLuzionet e mbledhjes virtuale / CAPSCA EUR/08



Në përfundim të mbledhjes dy ditore (11-12 Nëntor 2020), të organizuar nga Zyra Rajonale e ICAOs për Evropën dhe Atlantikun e Veriut (ICAO EUR/NAT) për Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Ngjarjeve të Shëndetit Publik ne Aviacionin Civil (CAPSCA EUR/08), pjesëmarrësit, mes të cilëve dhe përfaqësues të Autoritetit të Aviacionit Civil, miratuan konkluzionet.

1. COVID-19 krijon një realitet të ri për aviacionin – CAPSCA duhet të përshtatet për këtë realitet të ri.

2. Mbështetje për shtetet dhe rrjetet rajonale CAPSCA përmes zhvillimit urgjent të mjeteve elektronike në distancë (p.sh. listat e kontrollit dhe modelet dhe aktivitetet e implementimit (p.sh. trajnimi elektronik në distancë, implementimi i PHC I Pack, vlerësimet virtuale CAPSCA, Vizitat e Asistencës Teknike, etj.) është thelbësore.

3. Përcaktim i një strategjie zbatimi në nivel global dhe rajonal për të forcuar nivelet e zbatimit të standardeve dhe procedurave gjatë kohës së "paqes" p.sh. planifikimi i gatishmërisë, ushtrime trajnuese, etj. Ndikimi negativ i zbatimit të ulët është shumë më i madh sesa ndikimi pozitiv i zbatimit të duhur në sytë e publikut që udhëton dhe masmedias.



4. Shtetet inkurajohen që të trajnojnë ekspertë përmes Paketës së Trajnimit të ICAOs "Kryerja e një vizite të asistencës teknike në Shtetet Anëtare të CAPSCA dhe Aeroportet" në mënyrë që të rrisin ndërtimin e kapaciteteve në nivelin kombëtar dhe të krijojnë një grup ekspertësh të certifikuar në nivel rajonal, të cilët mund të kryejnë vizita të ndihmës CAPSCA.

5. Vazhdim i mbështetjes së punës rregullatore globale për të promovuar harmonizimin global të SARP-ve, rregulloreve dhe udhëzimeve (p.sh. zhvillimin e rekomandimeve të CAPSCA dhe dokumenteve mbështetëse të udhëzimeve të tilla si Dokumenti i Udhëzimit CART Take Off, manualët përkatëse të ICAO etj.) përmes koordinimit me të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë industrinë.

6. Ndërtim nën shembullin e suksesshëm të ICAO EUR / NAT-EASA / ECDC për të rritur bashkëpunimin në nivel rajonal për të mbështetur rifillimin e sektorit të aviacionit për të shmangur fragmentimin dhe mbivendosjen e aktiviteteve brenda Organizatave ndërkombëtare dhe industrisë, p.sh. udhëzimet, monitorimin dhe raportimin.

7. Rishikim i strukturës së drejtimit të CAPSCA për të forcuar funksionimin dhe pjesëmarrjen e rrjeteve dhe ekspertëve rajonalë të CAPSCA për të mbështetur zhvillimin rregullator dhe aktivitetet e zbatimit.

8. Identifikim dhe koordinim i veprimet të përbashkëta me Shtetet dhe Selinë Qendrore për të prezantuar dhe krijuar ndërgjegjësimin për çështjet e CAPSCA në forumet përkatëse të ICAO (p.sh. Dokumentet e Punës (WP) për Këshillin, Konferencën e Nivelit të Lartë për Sigurinë (HLSC), Kolegjet etj.)

9. ICAO ka krijuar me sukses një bazë të besueshme dhe të përditësuar të informacionit për të adresuar sfidën aktuale COVID-19 Infodemike. Kjo duhet të mirëmbahet me metodat e përmirësuara të shpërndarjes.

Shënim: Në këtë aktivitet Shtetet Anëtare të ICAO paraqiten perspektivën e tyre. Përfaqësuesja e Shqipërisë (AAC), Znj. Eda Gazheli paraqiti punën, masat e zbatuara gjatë pandemisë COVID-19, mësimet e nxjerra dhe rrugën e ecjes përpara për rikthimin e operimeve normale. Të gjithë dokumentacionin në Anglisht për mbledhjen e CAPSCA-EUR/08 e gjeni në faqen e internetit të Zyrës së ICAO EUR/NAT

<https://www.icao.int/EURNAT/Pages/Other-Meetings.aspx>



EASA përcakton kushtet për kthimin në shërbim të avionit Boeing 737 MAX

Agjencia e Bashkimit Evropian e Aviacionit për Sigurinë në Operim (EASA) publikoi për konsultim publik për një periudhë konsultimi 28-ditore një Propozim për Direktivën e Vlefshmërisë Ajrore (PAD) në lidhje me tipin e avionit **Boeing 737 MAX**, duke sinjalizuar synimin e saj për të aprovuar kthimin e avionit në qiellin e Evropës brenda disa javësh .

Publikimi përfundimtar pritet nga mesi i janarit 2021. Pas kthimit në shërbim të 737 MAX, EASA është zotuar të monitorojë nga afër avionin në shërbim, për të lejuar zbulimin e hershëm të çdo problemi që mund të shfaqet.

Ky lajm pason njoftimin e Federatës Amerikane të Aviacionit, Shteti i Dizenjimit të avionit Boeing, i cili publikoi më datë 20 Nëntor, 2020 miratimin përfundimtar të modifikimit të tipit 727 MAX në Regjistrin Federal.



Më shumë hollësi gjeni tek: <https://ad.easa.europa.eu/ad/20-184>

MBI REZULTATET E MONITORIMIT TË MASAVE ANTICOID NË SEKTORIN E TRANSPORTIT AJROR

Enkelejda Hajdëri - Shefe e Sektorit për të Drejtat e Pasagjerëve në Transportin Ajror dhe kryetare e Grupit të Monitorimit (SDP/AAC) sjell një raport mbi rezultatet e monitorimit të kryer për implementimin e masave me qëllim parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së COVID-19 në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza” dhe operatorëve ajror për periudhën tetor - nëntor 2020.

Në qendër të veprimtarisë monitoruese ka qënë verifikimi sesi këto subjekte kanë siguruar zbatimin e kërkesave të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë për protokollin e operimit në transportin ajror,



Grupi i punës ka gjetur se janë marrë masa për të garantuar shëndetin e pasagjerëve, ekuipazhit dhe punonjësve të angazhuar në transportin ajror duke veçuar masat:

- Në zonën e check-in, në zonën e kontrollit të sigurisë së aviacionit, të kontrollit të pasaportave në nisje dhe në mbërritje, si dhe në zonën tranzit ku është vërtetuar respektimi i distancës fizike të kërkuar si dhe mbajtja e maskave gjatë gjithë kohës. TIA ka angazhuar staf në të gjitha zonat e përmendura me sipër, me qëllim ndërgjegjësimin e pasagjerëve për respektimin e masave në përputhje me kërkesat e protokollit të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit.
- Në vendosjen e çadrave dhe krijimin e korsive të dedikuara për lëvizjen e pasagjerëve në zonën ajrore drejt hyrjes në kontrollin e pasaportave në mbërritje, ka rezultuar të jetë një masë efektive duke ndihmuar në një menaxhim më të mirë të fluksit të pasagjerëve dhe shmangien e rradhëve të gjata.
- Në zonën e bagazheve, në ndryshim nga muajt e mëparshëm, situata paraqitet paproblematike. Ka prezencë të stafit të sigurisë gjatë gjithë kohës në këtë zonë.
- Përdorimin e audios ndërgjegjëse që transmetohet në intervale prej 15-20 minutash, gjë që konsiston në një rritje të ndjeshme frekuence krahasur me muajt e mëparshëm.
- Në tabelat që ilustrojnë masat e distancimit fizik e social, në dezinfektimet dhe mbajtjen e një niveli të lartë pastërtisë dhe higjenes.

TIA ka vijuar plotësimin me seriozitet të rekomandimeve të dërguara nga Autoriteti i Aviacionit Civil duke treguar vëmendje të shtuar për përdorimin e vazhdueshëm të Masave Mbrojtëse Personale nga stafi i Ndihmës së pare.

Lidhur me vonesat dhe anulimet e fluturimeve ajrore me nisje nga TIA është vërtetuar se nuk ka patur vonesa mbi 2 orë ose anulime fluturimesh të njoftuara më parë. SDP ka vijuar me mbështetjen dhe menaxhimin e përgjigjeve ndaj pasagjerëve që kanë paraqitur ankesa ndaj kompanive ajrore për respektimin e të drejtave në përputhje me Udhëzimin Nr.1, datë 26.2.2013 “Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe të anulimit ose vonesës gjatë fluturimit”.

TË DREJTAT E PASAGJERËVE DHE PANDEMIA COVID-19

Përhapja e pandemisë së COVID - 19 në fillim të vitit 2020 ka trazuar shumë aspekte të jetës tonë të përditëshme dhe ka pasur ndikim në shumë sektorë të ekonomisë. Industria e udhëtimit është ndikuar gjithashtu – sikurse shumë sektorë të tjerë. Pandemia është një shqetësim për Evropën dhe mbarë botën. Komisioni Evropian ndërkaq po koordinon një përgjigje të përbashkët ndaj përhapjes së koronavirusit. Po ndërmerr një veprim të vendosur për të zbutur ndikimin socio-ekonomik dhe për të arritur një rimëkëmbje të shpejtë në Bashkimin Evropian.

Respektimi i të drejtave të pasagjerëve është në thelbin e rivendosjes së besimit të

konsumatorit, i cili është thelbësor për rimëkëmbjen - jo vetëm në aviacion - pas sfidave ekonomike dhe sociale të paraqitura nga shpërthimi i paparë i COVID-19.

Pandemia COVID-19 dhe mbyllja më pas e kufijve brenda BE-së midis marsit dhe mesit të qershorit 2020, e ndjekur nga masa të tjera kufizuese që nga ajo kohë, kishin ngritur pikëpyetje në lidhje me zbatimin, ushtrimin dhe zbatimin e të drejtave të pasagjerëve të BE-së. Sipas rregullave për të drejtat e pasagjerëve, e drejta e pasagjerit për rimbursim të plotë në rast të udhëtimit të anuluar mbetet e vlefshme. Komisioni vazhdimisht e ka bërë të qartë këtë, përmes ndër të tjera duke miratuar Udhëzime

Interpretuese, si dhe një rekomandim mbi kuponat (vouchers).

Komisioni është në dialog me Shtetet Anëtare për ndjekjen e mëtejshme. Komisioni vendosi në tetor 2020 të mbajë rishikimin e propozuar të Rregullores (KE) Nr. 261/2004 për të drejtat e pasagjerëve ajrorë dhe Rregullores (KE) Nr. 2027/97 mbi përgjegjësinë e transportuesit ajror në lidhje me transportin e pasagjerëve dhe bagazhet e tyre në rrugë ajrore në një skedar në pritje dhe me përparësi në programin e tij të punës për 2021. Komisioni mori në mbrojtje të vazhdojë negociatat për këtë skedar brenda Këshillit, pasi ato u ndalën në kontekstin e COVID-19 në Mars 2020.





TË KUJTOJMË:

Se të gjithë palët e interesit ranë dakord që një rishikim i rregullores ekzistuese ishte i nevojshëm. Në vitin 2013, Komisioni propozoi një rishikim të Rregullores (KE) Nr. 261/2004 dhe Rregullores (KE) Nr. 2027/97 mbi përgjegjësinë e transportuesit ajror në lidhje me transportin e pasagjerëve dhe bagazhet e tyre në rrugë ajrore në zona të ndryshme për të lejuar efektivitetin dhe zbatimin e vazhdueshëm të të drejtave të pasagjerëve ajror, shqyrtimin më të mirë të kapaciteteve financiare të transportuesve ajrorë dhe zbatimin më të mirë në lidhje me bagazhet e keqpërdorura. Parlamenti Evropian përfundoi shqyrtimin e tij të parë në shkurt 2014. Propozimi ishte në pritje në Këshill që nga maji 2015 për shkak të një mosmarrëveshje midis Spanjës dhe Mbretërisë së Bashkuar në lidhje me aeroportin e Gjibraltarit, por nën presidencat Finlandeze dhe Kroate propozimi u rikthye në tryezë për 2019/2020.

Në këtë kontekst, Komisioni publikoi një studim për gjetjen e fakteve mbi të drejtat e pasagjerëve në janar 2020, përgjatë sondazhit të Eurobarometer-it mbi të drejtat e pasagjerëve të BE. Studimi u përqëndrua në ndërprerjet e udhëtimeve me të cilat përballen pasagjerët, veçanërisht nga këndvështrimi i pasagjerëve, linjave ajrore dhe aeroporteve. Studimi gjithashtu analizoi monitorimin dhe zbatimin, mbrojtjen e përgjithshme të konsumatorit, zhvillimet ndërkombëtare si dhe rastet e pamundësisë financiare të linjave ajrore. Ai tregoi se nevoja

për reformë është bërë edhe më urgjente që nga viti 2013: niveli i fluturimeve të ndërprera, për sa i përket anulimeve dhe vonesave për dy orë, është rritur ndjeshëm dhe për pasagjerët është akoma mjaft e vështirë të zbatojnë të drejtat e tyre për shkak të kompleksitetit të mjedisit rregullator dhe mungesës së informacionit. Për linjat ajrore, barra është rritur, e nxitur nga nivelet e rritura të shqetësimeve dhe nivelet në rritje të kërkesave. Për sa i përket përparësive, udhëtarët renditën kujdesin dhe ndihmën që do të ofrohet në rast të ndërprerjes së

udhëtimit si më të rëndësishmen. Ri-drejtimi, duke u siguruar që pasagjerët të mbërrijnë në destinacionin e tyre sa më shpejt të jetë e mundur, u rendit i dyti, dhe rimbursimi dhe / ose kompensimi për t'u paguar (kur është e nevojshme) i treti. Konteksti i COVID-19 tregon se një reformë e rregullave aktuale për të drejtat e pasagjerëve ajror është edhe më e nevojshme: linjat ajrore u përballën me një situatë të paparë dhe udhëtarët përjetuan vështirësi në zbatimin e të drejtave të tyre nëse linjat ajrore anulonin fluturimet. Besimi i udhëtarëve në aviacion si

një mënyrë e besueshme, e zgjuar dhe e qëndrueshme e transportit është thelbësore për një shërim të shpejtë. Përvoja e muajve të kaluar ka treguar se kishte disa çështje kryesore për shkak të krizës, ndërsa në fillim të pandemisë në mars 2020, pyetjet u përqëndruan në të drejtën e kompensimit - dmth ishte konteksti i COVID-19 që duhej konsideruar si një rrethanë e jashtëzakonshme, cila i shfajëson transportuesit nga një kompensim që duhet të paguhet? Shpejt u pa se problemi kryesor doli të ishte zgjedhja e lirë e udhëtarëve midis rimbursimit të parave dhe

kuponëve - dhe informacionit të saktë të pasagjerëve mbi to. Një temë tjetër aktuale ishte se cilat të drejta i bashkangjiten një vendimi të pasagjerit për të mos udhëtuar për shkak të pandemisë (bazuar në masat që lidhen me COVID-19 ose rekomandimet e Shtetit Anëtar të nisjes ose mbërritjes), pasi ky aspekt nuk është i mbuluar nga rregullat aktuale për të drejtat e pasagjerëve ajrorë (vetëm anulime nga transportuesit). Nuk është për t'u habitur, që opinionet se si t'i zgjidhin këto çështje ndryshojnë shumë. Për shembull: si të mbrohen udhëtarët dhe

transportuesit në lidhje me rimbursimet?

Zgjidhjet e propozuara variojnë nga një Fond i Evropës për Garancinë e Udhëtarëve deri te propozimi për t'ja lënë tregut mbrojtjen e të drejtave të rimbursimit dhe kuponëve.

A mund të jetë një zgjidhje një pezullim i përkohshëm i disa të drejtave të pasagjerëve? Apo më mirë e kundërta, të drejtat e zgjeruara të pasagjerëve? Po rregullat për ndërmjetësuesit (shitësit e biletave, operatorët turistikë)?

Komisioni ka në plan të miratojë dhe publikojë një strategji gjithëpërfshirëse për lëvizshmërinë e qëndrueshme dhe të zgjuar përpara fundit të këtij viti. Një konsultim i hapur publik u dha të gjithë palëve të interesit mundësinë për të bërë të njohur pikëpamjet e tyre se si kjo strategji duhet të adresojë çështjet aktuale. Prandaj, në këtë moment në kohë është ende herët për të hyrë në detaje të mëtejshme mbi këtë strategji, kështu që nuk ka ende përgjigje në pyetjen nëse epidemia do të ndryshojë të drejtat e pasagjerëve. Ajo që është e sigurt është se të drejtat e pasagjerëve janë një faktor i rëndësishëm në - shpresojmë së shpejti - rimëkëmbjen e industrisë së linjave ajrore. Ato janë të rëndësishme për të vendosur besimin dhe besimin dhe kjo do të jetë baza për një ngritje të shpejtë dhe të suksesshme të industrisë së linjave ajrore. Pikëpamjet tuaja mbi reformën e të drejtave të pasagjerëve ajrorë në kontekstin e pandemive ose krizave të ngjashme janë sigurisht më të mirëseardhura!

Nga Elisabeth Kotthaus - Kryetare e Njesisë për Çështjet Sociale, Mundësi të Barabarta dhe të Drejtat e Pasagjerëve, Drejtorja e Përgjithshme për Lëvizshmërinë dhe Transportin, Komisioni Evropian

Përshtati në shqip: Bujar Hazizaj

Burimi <https://www.ecac-ceac.org/documents/10189/35041/ECAC+news>

Manual i ri i Testimit nga ICAO

ICAO publikoi në datë 23 Nëntor 2020 një buletin të emërtuar Manual i ri i Testimit dhe Manuali i Masave Ndërkufitare të Menaxhimit të Rrezikut (Doc 10152) https://www.icao.int/covid/cart/Documents/Doc10152_Testing_PDF, i zhvilluar nga anëtarët e grupit të dedikuar CAPSCA të krijuar në 2009 për parandalimin dhe menaxhimin e publikut në ngjarjet shëndetësore në aviacionin civil.

Publikimi i ri është në dispozicion falas në portalin online COVID-19 ([COVID-19 online portal](#)) të OKB, së bashku me udhëzimet, mjetet dhe burimet gjithëpërfshirëse që janë vënë në dispozicion të vendeve që nga fillimi i pandemisë.

"Ky manual i ri për menaxhimin e rrezikut është krijuar për të ndihmuar vendet që të vlerësojnë dhe përfshijnë testet personale si pjesë e përgjigjeve të tyre të përgjithshme të transportit ajror të shëndetit publik ndaj COVID-19", komentoi Sekretari i Përgjithshëm i ICAO Dr. Fang Liu.

Grupi i punës i CAPSCA për zhvillimin e dokumentit për testimet u ngrit më herët këtë vit, dhe drejtohet nga Task Forca për Ringritjen e Aviacionit ([Aviation Recovery Task Force \(CART\)](#)) e themeluar nga Këshilli drejtues diplomatik i ICAO-s. E përbërë nga ekspertë të 16 qeverive, të OBSH (WHO), OBT (UNWTO), trupa rajonale dhe grupe të industrisë, Task Forca ka kërkuar që ICAO ti ofroj vendeve udhëzues të përditësuar në mbështetje të vlerësimeve efektive për mundësitë e testimit të sëmundjeve për udhëtarët në transportin ajror.

"Task Forca (CART) së fundi ka publikuar dokumentin për Fazën e II të përgjigjes dhe udhëzues për Shtetet," ka nënvizuar Presidenti i Këshillit të ICAOs Z. Salvatore Sciacchitano.

"Këto përfshijnë Rekomandimin e tij të ri 13, i cili thekson rëndësinë e mjeteve të vlerësimit të rrezikut që përmban ky manual për vlerësimin e zgjidhjeve të reja të testimit, ndërsa nënvizon gjithashtu se testet ende nuk rekomandohen botërisht nga autoritetet e shëndetit publik si një metodë rutinë e shqyrtimit të shëndetit."

Monitorimi nga ICAO i trafikut global ka regjistruar që kërkesa e udhëtarëve për udhëtime ajrore ra me 90% në fillimin e pandemisë në prill të këtij viti dhe aktualisht vlerëson se totali i përgjithshëm i pasagjerëve në 2020 do të ulet me 60% krahasuar me 2019.

Burimet e lëshuara nga ICAO CART dhe Sekretariati aktualisht po ndihmojnë dhe përafrojnë përgjigjet pandemike të vendeve në transportin ajror, duke përfshirë inovacionin e tyre të korridoreve të shëndetit publik dhe zgjidhje të ngjashme të fluskave të udhëtimit (iPack) midis destinacioneve specifike ndërkombëtare.

Vitin 2021 si Viti i Kulturës për Sigurinë e Aviacionit Civil

TË PËRMIRËSOJMË KULTURËN E SIGURISË SË AVIACIONIT DUKE NDËRLIDHUR KONTAKTET

Këshilli i ICAOs e ka përcaktuar vitin 2021 si Vitin e Kulturës për Sigurinë e Aviacionit Civil (YOSC). Fillimisht i destinuar për vitin 2020, pas miratimit të tij në Sesionin e 40-të të Asamblesë së ICAO, YOSC tani është zgjatur deri në fund të 2021 për shkak të pandemisë. Gjatë 12 muajve të ardhshëm, Sekretariati ICAO do të përqendrohet në aktivitetet e mëposhtme:

1. Zbatimin e një fushatë globale të kulturës së sigurisë, e cila do të mbështesë organizimin e veprimtarive kombëtare, rajonale dhe globale për të rritur ndërgjegjësimin e sigurisë në aviacion, veçanërisht në dritën e COVID-19;

2. Intensifikimin e bashkëpunimit

me Shtetet dhe industrinë në mbështetjen e përpjekjeve për të promovuar kulturën e sigurisë në komunitetin më të madh të aviacionit, ku siguria është përgjegjësia e të gjithëve;

3. Lëshimin e udhëzimeve përkatëse mbi strategjitë praktike

të komunikimit, planet dhe fushatat e kulturës së sigurisë;

4. Të vazhdoj të ofrojë trajnim dhe ndihmë të përqendruar në promovimin e një kulture efektive dhe të qëndrueshme të sigurisë brenda të gjitha organizatave të përfshira në aviacionin civil.

Informacione dhe udhëzime shtesë mbi këtë temë janë gjithashtu në dispozicion në faqen e internetit të Kulturës së Sigurisë ICAO nën Platformën e Kulturës së Sigurisë në:

[https:// www.icao.int/Security/Security-Culture/Pages/Best-practices.aspx](https://www.icao.int/Security/Security-Culture/Pages/Best-practices.aspx)

Për më tepër, në këtë kuadër do të ketë dhe një Simpozium virtual AVSEC falas në 18 Dhjetor 2020 me temën "Përmirësimi i Kulturës së Sigurisë duke Ndërlidhur Pikat e kontaktit". Informacion dhe detaje të mëtejshme mund të gjenden në faqen e internetit të ngjarjes:

<https://www.icao.int/Meetings/AVSEC2020/Pages/Programme.aspx>

Studimi i Harvardit: Fluturimi paraqet rrezik më të ulët të COVID-19 sesa pazari i ushqimeve apo darka jashtë

Një studim i ri portë më portë nga shkencëtarët e Harvard's T.H. Chan, shkolla e shëndetit publik, është studimi më gjithëpërfshirës deri tani për të arritur në përfundimin se masat e marra nga kompanitë ajrore për të mbrojtur pasagjerët dhe stafin nga covid 19 kanë rezultuar në risk shumë të ulët të ekspozimit gjatë një udhëtimit ajror.

Deri më sot, Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve nuk kanë konfirmuar një rast të vetëm të transmetimit COVID-19 në një aeroplan të SHBA.

Rreziku i transmetimit COVID-19 në bord të avionëve është nën atë të aktiviteteve të tjera rutinë gjatë pandemisë, të tilla si pazari i ushqimeve ose ngrënie jashtë," përfunduan studiuesit e Harvardit.

Zbatimi i këtyre strategjive të shtresuara të zbutjes së rrezikut... kërkon pajtueshmëri të pasagjerëve dhe linjave ajrore por do të ndihmojë për të siguruar që udhëtimet ajrore të jenë aq të sigurta ose më të sigurta se sa aktivitetet rutinë që njerëzit kryejnë gjatë këtyre kohërave.

Raporti arrin në përfundimin se përdorimi universal i maskave të fytyrës, protokollet e zellshme të pastrimit dhe sistemet e përparuara të ventilimit dhe filtrimit ofrojnë mbrojtje të konsiderueshme kundër COVID-19, duke ulur rrezikun e transmetimit në një aeroplan në nivele minimale.

Veshja e maskave të fytyrës nga pasagjerët dhe ekuipazhi është thelbësore.




Studimi përcaktoi se përdorimi i maskave për fytyrën ishte pjesa më thelbësore e një grupi masash gjithëpërfshirëse për të zvogëluar COVID-19 gjatë udhëtimeve ajrore.

Delta ishte një nga linjat e para ajrore që u kërkoj klientëve dhe punonjësve të mbanin një maskë ose fytyrë të mbuluar nëpër pikat e kontaktit të Delta në aeroporte dhe në bordin e avionit.

Klientëve u kërkohej të njohin si pjesë të procesit të check-in gatishmërinë e tyre për të mbajtur një maskë gjatë gjithë udhëtimit. Dhe klientët të cilët kanë një gjendje themelore që i pengon ata të mbajnë një maskë të kryejnë një proces "Clearance to fly" pas mbërritjes në aeroport.

Pastrimi i thellë i sipërfaqeve të kontaktit në avion, dezinfekton, heq kontaminimin.



Raportet e auditeve gjithashtu flasin për praktika të gjera pastrimi gjatë dhe para fluturimit. Shoqëruesit e fluturimit spërkasin dhe pastrojnë sipërfaqet e kontaktit disa herë gjatë fluturimit dhe sigurojnë që çdo gjë është e desinfektuar përpara fillimit të fluturimit.

Sistemet e ventilimit në aeroplanët e pasagjerëve janë shumë efektive në freskimin, filtrimin e ajrit.

Ekipi hulumtues i Harvardit vuri në dukje "sistemet mjaft të efektshme të ventilimit" në avionë, të cilët zbusin ekspozimin ndaj sëmundjes nga filtrimi i shpejtë dhe i vazhdueshëm dhe shkëmbimi i ajrit të kabinës. Mbajtja e ajrit të pastër dhe të sigurt gjatë fluturimit është një nga shtresat më themelore të mbrojtjes që kompanitë ajrore synojnë t'u ofrojnë klientëve dhe punonjësve.

"Ashtu siç jemi përqendruar në sigurimin e ajrit të pastër në bord duke zëvendësuar filtrat tanë të shkallës industriale HEPA dy herë më shpesh sesa rekomandohet, ne jemi të përkushtuar gjithashtu të sigurojmë ajër të pastër në tokë.

Delta po zëvendëson sistemet aktuale të filtrimit të ajrit që pompojnë ajrin e jashtëm në avionët tanë dhe avionët e parkuar me filtra LEED Platinum MERV14 që rezultojnë në një reduktim më shumë se 40% të grimcave të ajrit dhe ajrit të pastër në ato hapësira gjatë hipjes dhe zbritjes nga avioni."u shprehën menaxherët e Delta.

Masat e shtresuara për zbutjen e rrezikut do të sigurojnë që udhëtimet ajrore të mbeten të sigurta ose më të sigurta se aktivitetet e tjera rutinë

Studimi arriti në përfundimin se nevojitet një "kombinim i masave të kontrollit të infeksionit" për të zvogëluar rrezikun e transmetimit të COVID-19.

Dhe kompanitë kanë siguruar shtresa të mbrojtjes nga check-in deri në tërheqjen e bagazheve për të ofruar një standard të ri pastërtie, më shumë hapësirë dhe shërbim dhe kujdes më të sigurt për klientët dhe punonjësit njësoj.



Në këtë numër BULETINI MUJOR NËNTOR 2020

- **Rihapet gara për Aeroportin e Vlorës**
Ministria Balluku zbulon detajet e garës
- **Znj. Kraja takim virtual me Drejtorin e Përgjithshëm të Eurocontrol**
- **Konkluzionet e mbledhjes virtuale /CAPSCA EUR/08**
- **EASA përcakton kushtet për kthimin në shërbim të avionit Boeing 737 MAX**
- **Mbi rezultatet e monitorimit të masave Anticovid në sektorin e transportit ajror**
- **TË DREJTAT E PASAGJERËVE DHE PANDEMIA COVID-19**
- **Manual i ri i Testimit nga ICAO**
- **Vitin 2021 si Viti i Kulturës për Sigurinë e Aviacionit Civil**
- **Fluturimi paraqet rrezik më të ulët të COVID-19 sesa pazari i ushqimeve apo darka jashtë**

KONTAKT

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

ZYRA QËNDRORE
Rr. "Sulejman Delvina" PO Box 205
Tiranë, Shqipëri
TEL: +355 4 225 12 20
WEB: www.aac.gov.al
EMAIL: info@acaa.gov.al

Sektori Për Të Drejtat e Pasagjerit

TELEFON: +355 42 381 959
+355 44 539 959
EMAIL: pax@acaa.gov.al

Redaktoi:

Z. BUJAR HAZIZAJ - Koordinator Për Të Drejtën Për Informim
EMAIL: Bujar.Hazizaj@acaa.gov.al
ZNJ. EDLIRA SALIAJ - KËSHILLTARE PËR MEDIAN
EMAIL: Edlira.Saliaj@acaa.gov.al

Media Sociale



facebook.com/AlbanianCAA

autoriteti.aviacionit.civil